

- **FINANCA Analize ekonomiko - financiare Janar – Dhjetor 2022.**

Në kudër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit por edhe në respekt të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, bazuar në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave nr.22 datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore” si dhe në zbatim të udhëzimit plotësues nr.1, datë 10.01.2022, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2022”, në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për 12-mujorin e vitit 2022 për Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore .

Buxheti i shtetit është instrumenti financiar kryesor për zbatimin e politikave dhe objektivave të institucionit

Në tabelën në vijim ju paraqesim realizimin e fondeve buxhetore për periudhën Janar - Dhjetor viti 2022 sipas artikujve buxhetore.

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor Plani	12/ Mujori Janar- Dhjetor 2022 (000)		% e realizimit
			Plani 12-mujor/progresiv	Realizimi Fakti 12-mujor progresiv	
600+601	Paga Sigurime	131.454	131.454	131.454	100
602	Mallra Shërbime	30.894	31.242	28.094	90
231	Investime	4.500	4.500	3.502	78
606	Fondi i vecante	0.348	2.738	2.639	96.3
6	UNICEF	1.675		1.175	
	<b>TOTALI</b>	<b>168.871</b>	<b>169.934</b>	<b>166.864</b>	<b>98.1</b>

Të ardhurat nga të ardhurat dytesore dhe kamat vonesat e tyre për periudhën Janar- Dhjetor 2022 janë **18,019,708** (Tetëmbëdhjetë milion e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë, nga të cilat **17.652.470** leke janë të ardhura nga gjocat dhe **367. 238** lekë janë të ardhurat nga kamat vonesat. Sanksione të vendosura për vitin 2022, janë 135.

Gjoca të arketuara vullnetarisht për vitin 2022, janë 64 në vlerë prej 9.355.000 leke.

Gjoca me permbarim janë 2 në vlerë prej 270.000 leke.

Dy gjoca arketohen me akt marreveshje në vlerë prej 164.000 leke dhe vazhdojnë arketimin edhe për vitin 2023.

1. Art, buxh 600+601 (Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore) realizimi është 100%.

2. Art, buxh 602 (Mallra e sherbime) realizimi eshte 90%
3. Art, buxh 231 ( Investime) realizimi eshte 78%.

Totali i realizimit te buxhetit per periudhen janar – Dhjetor eshte 98.1%.